

Specifikimet Teknike

Objekti: Paisje, mobileri për shkollën 9-vjeçare “Azem Hajdari” Babrru.

1;3. Tavoline nxenesi - cikli i ulët (120 x 64 x 45cm) - cikli i larte (120 x 75 x 45cm)



Syprina MDF e melaminuar dhe e frezuar perimetralisht, duhet te kete trashesine me te madhe ose te barabarte me 18 mm, me veshje laminate ne menyre qe te duroje gervishtje. Montimi i syprines me skeletin duhet te behet me vida te fshehta ose me percina me koke Ø4.

- Ne pjesen e poshtme te saj te jene te vendosura nje element me permasa 110x26 cm MDF e melaminuar 16mm dhe e frezuar perimetralisht, qe sherben per mbajtje te librave te nxenesve.
- Montimi i syprines me skeletin te behet me vida te fshehta.
- Ne pjesen ballore te vendoset nje element me permasa 110 x 14.5 cm me material MDF e melaminuar dhe e frezuar perimetralisht.
- Kembet vertikale duhet te jene me profil tubolar oval ku ne te dyja anet e tubit te jete i rrumbullakosur, qe te japi fortesine dhe imazhin e dukshem te tavolines, me seksion jo me te vogel 50x25 mm dhe spesor jo me te vogel se 1.2 - 1.5mm. Pjesa fundore do te jete me profil tubularoval ku ne te dyja anet i rrumbullakosur jo me te vogel se 50x25mm, me spesor jo me te vogel se 1.2 - 1.5mm. Pjesa e harkut, duhet te jete me profil tubolar me seksion jo me te vogel se 20x20mm, spesor jo me te vogel se 1.2 - 1.5mm, e Iyer me boje elektrostatische ngjyre sipas kerkeses se klientit. Ne fundet e tyre te kene tapa plastike per shmangien e zhurmave te ndryshme.
- Preferohet ngjyra e metalit e zeze ose gri.

Verejtje: Shmangiet lejohen 5% nga te dhenat qe jane vertdosur ne specifikime.

2;4. Karrige nxenesi - cikeli i ulët (35x38x37/70 cm) cikei i lart-

(35x38x42-45/75cm)

- Mbeshteteset dhe uleset te jene me material frezilit, i derdhur ne te gjithë trupin e ndejtjes dhe te shpines. Materiali i derdhur i frezilitit duhet te jete i qëndrueshem kunder lageshtires dhe gervishtjeve. Ndejtsia dhe shpina te jene te harkuara (me gropa ne qendren e uleses dhe ne forme anatomike).

- Skeleti duhet te jete me profil tubolar oval ku ne te dyja anet e tubit te jete i~rumbullakosur, qe te japi fortesine dhe imazhin e dukshem te kariges, me seksion jo me te vogel 30 x15mm dhe spesor jo me te vogel se 1.2 - 1.5mm.
- I gjithe skeleti te jete i salduar me sal dim te vazhduar me argon dhe i Iyer me boje elektrostatische, ne pjeset fundore te kete tapa plastike.
- Ndejtesia dhe shpina eshte kusht i domosdoshem per implementimin e kontrates.



5. Tavoline mesuesi (120 x 60 x 76 cm)_cikli-i larte, arsimi i mesem



- Suprina te ndertohet me melamine me trashesi 25mm me rezistence te larte kunder gervishtjeve dhe njollave;
- Permasat e suprines te jene 120x60cm.
 - Veshja perimetrare e te gjithe elementeve perberes te saj te jene PVC 0.8mm.
- Pjeset anesore te jene te te njejtit material me permasa 70x60cm dhe me spesor 18 mm.
- Kembet te jene me mekanizem nivelues dhe me tapa per te shmangur gervishtjet me parketin ose pllakat.
- Bashkimi i suprines me kembet behet me aksesor te padukshem.
- Montimi dhe cmontimi te jete sa me i thjeshte dhe te paketohen qe te mos demtohen gjate transportit.

Verejtje:

1. *Shmningiet lejohen 5% nga te dhenat qe jane vendosur ne specifikime.*

6.Karrige per mesues me tapiceri (510 x450 x780 mm)



- Shpina dhe ulesja te jene te beta me plastike te zeze, rezistente ndaj goditjeve. te mbushura me sfungjer te cilesise se larte me dendesi 40kg/m³, i ngjitur me iende ngjitese, per te krijuar formen ergonomike, dhe te veshura me tekstil (tapiceri).
- Pjesa e poshtme e uleses dhe e pasme e shpinores mbulohen me kapak plastik te se njejtes forme.
- Permasat e uleses te jene: 450x400mm, ndersa te shpinores te jene 300x450 mm.
- Lartesia e uleses dhe shpinores te jene perkatesisht 400-460mm dhe 700-750 mm.
- Struktura mbajtese te jete e perbere prej profil celiku oval me permasa 30x15mm, me spesor jo me te vogel se 1.2 mm, i harkuar me kalnder.
- Kjo strukture te jete e salduar me argon ose shkarkese elektrike dhe e Iyer me fume elektrostetike.
- Fundet e kembeve te jene tapa plastike te trasha 5mm per te qene jetegjate ne perdorimin e tyre.
- Ngjyra e karriges te jete sipas deshires se klientit.

7.Dollap per klasa



6 cm.


- Permasat: jo me pak se 90x45x185cm.
- Materiali i perdorur do te jete melamine me trashesi jo me te vogel se 16 mm, bordet anesore te se cilit jane te veshura me material plastik pvc me spesor jo me te vogel se 0.8 mm.
- Pjesa e pasme e dollapit eshte e perbere me fiber me trashesi jo me pak se 3mm.
- Te kete 2 kanata me hapje 90°, doreza e brava me celes.
- I gjithë dollapi mbeshetetet mbi kembe plastike me lartesi 6 cm.
- Pjesa e brendshme e dollapit do te ndahet ne 4 hapësira te barabarta me ane te 3 sergjenave
- Lart dhe poshte do te kete shula per fiksimin e kanateve.

8.Dërrasë e zezë (120 x 180cm)




- Të dhënat teknike të sajë janë : Mënyrë tradicionale e paraqitjes.Shkruhet me shkumës. Sipërfaqe e lyer me ngjyrë të zezë ose jeshile, e lehtë për tu fshirë falë strukturës ekstra të imët të sipërfaqes. Sipërfaqe jo gërvishëse dhe rezistente ndaj acideve . Ngjyrë e zezë ose jeshile mat, me sipërfaqe jo reflekstuese.
- Dorëzimi bëhet duke përfshirë mbajtësen e shkumsave dhe kompletin e montimit.
- Përmasat totale : 120 x 180 cm.

9.Karrige per kabinetet



- Lartësia totale 85cm, kurse lartësia e ndenjeses nga dyshemeja jo me pak se 44cm
- Dimensionet e ndenjeses jo me pak se 40x40cm.
- Skeleti te realizohet nga dru ahu masiv, me seksion katror ose i rrumbullaket, i lyer me llak per te ruajtur ngjyren natyrale te drurit.
- Ndenjesja te realizohet me melamine, sfungjer dhe stof.
- Ne cdo rast duhet te sigurojne nje forme te harkuar.
- Ne cdo rast do jete e mbushur me sfungjer dhe e tapicuar me cope stofi ose lekure.
- Mbeshtesja te realizohet me ristela te kurbezuara jo me pak se dy ristela me gjeresi jo me pak se 5 cm ose nje e vetme me gjeresi jo me pak se 10 cm.

10.Tavoline per kabinet dyshe. (120×60×72)



- Syprina te ndertohet me melamine me trashes 25mm me rezistence te larte kunder gervishtjeve dhe njollave.
- Permasat e syprines te jene 120x60cm. Veshja perimetrale e te gjithë elementeve perberes te saj te jene PVC 0.8mm.

- Pjeset anesore te jene te te njejt material me permasa 70x60cm dhe me spesor 18 mm.
- Kembet te jene me mekanizem nivelues dhe me tapa per te shmangur gervishtjet me parketin ose pllakat.
- Bashkimi i syprines me kembet behet me aksesore te padukshem.
- Montimi dhe çmontimi te jete sa me i thjeshte dhe te paktohen qe te mos demtohen gjate transportit.


Verejtje:

- I. *Shmangiet lejohen 5% nga te dhenat qe jane vendosur ne specifikime.*

11.Tavoline per kabinetet treshe


- Përmasat e tavolinës 200x6x75 cm
- Sypruina e punës: Pllakë melaminë 18mm me bordime anesore PVC 0.8MM
- Skeleti me dimensione 200 x 6 x 75 cm, me profil tubolar jo më të vogël se 30 x 30 mm me spesor jo më të vogël se 1.2 – 1.58 mm.
- Ngjyra metal , ngjyra e syprinës përcaktohet në kushtet e lidhjes së kontratës
- Prodhim, furnizim dhe montim.

12. Dollap per kabinetet e kimise dhe biologjise



- Permasat: 90 x 45 x 185 cm.
- Skeleti dhe sergjenet do jene prej metali melamine me trashesi 18 mm. Bordet anesore te skeletit sefgjeneve dhe kapakeve te jene te rrethuara me material plastik PVC 0.8 mm. Poshte fiankeve do kete kembeza me mekanizem nivelues. Ne pjesen e poshtme deri ne lartesine 72 cm, do te kete dy kapake prej materiali melamine, me trashesi 1.8 cm qe mbyllen me çeles.
- Dollapi brenda ketyre dy kapakeve do jete i ndare ne dy pjese me ane te n'e sergjeni me lartesi te regjistrueshme. Pjesa e sipërme eshte e mbyllur me kapake xhami me /ose pa komize. Hapesira brenda kapakeve te xhamit do ndahet ne tre hapesira me ane te dy sergjeneve. Ngjyrat jane te ndryshme dhe percaktimi i sakte i tyre do te behet ne kushtet e lidhjes se kontrates. Prodhim, Furnizim dhe montim ne shkollë.

13. Dollap per kabinetet e fizikes



- Permasat: 90 x 45 x 185 cm.

Skeleti dhe sergjenet do jene prej materiali melamine me trashesi 18 mm.

- Bordet anesore te skeletit, sergjeneve dhe kapakeve te jene te rrethuara me material plastik PVC 0.8mm. Poshte fiankeve do kete kembeza me mekanizem nivelues. Ne pjesen e poshtme deri ne lartesine 72 cm, do te kete dy kapake prej materiali melamine,

me trashesi 1.8 cm qe mbyllen me çelës.

- Dollapi brenda ketyre dy kapakeve do jete i ndare ne dy pjese me ane te nje sergjene me lartesi te regjistrueshme. Pjesa e sipërme eshte e mbyllur me kapake xhami me /ose pa kornize. Hapesira brenda kapakeve te xhamit do ndahet ne tre hapesira me ane te dy sergjeneve. Ngjyrat jane te ndryshme dhe percaktimi i sakte i tyre do te behet ne kushtet e lidhjes se kontrates.

Prodhim, Furnizim dhe montim në shkollë.

14. Dollap per regjistra.

- Permasat rreth 90 x 45 x 185 cm
- Material i korpusit dhe i nenndarjeve:
- Material prej melamine 1.8 cm me bordim PVC 0.8mm.
- Raft! perbehet nga dy kapake te mbyllshem me celes. Rafti ka minimumi 6 ndarje horizontale.
- Rafti mbeshetetet mbi kembe 6 cm me mekanizem nivelues.

15 .Tavoline nxenesi dyvëndëshe per kompiuter



Permasat e tavolines per Deskop:


- Syprina: rreth 1400 x 700 x 750 mm
- Skeleti: rreth 1350 x 650 x 725 mm
- 2 cengela qe ndodhen nga brenda per te varur cantat e nxenesve
- Syprina e punes: Melamine 18mm e borduar me PVC 0.8mm; dhe qe del mbi skelet.

- Skeleti është i ndertuar me profil metalik tubolar me seksion katror 30x30mm, me spesor jo me te vogel se 1.2 - 1.5mm kembet metalike jane te pajisura me vidha rregullimi lartesis per te siguruar nje nivel horizontal te pavarur nga mosnivele i dyshemese.
- Nen syprine majtas ose djathtas është elementi mbajtes i njesise qendrore e bere me material melanine 18mm me permasa : 500 x 250 x 600 mm.
 - Ngjyra metal.
 - Prodhim. fumizim dhe montim.

16. Tavolinë e mësuesit per kabinetin e informatikes

- Eshte njelloj me tavolinen e nxenesit me ndrveshim qe ne krahun tjeter te vendosjes se hardiskut jane te vendosur 3 (tre) sirtare te cilet monlohen nen svprinen e tavolines, me permasa: lartesia 15 cm. gjeresia 40 cm dhe thellesia 60 cm.
- Ngjyra metal.

17. Karrige per nxenes per kabinetin e informatikes



- Lartesia totale 85cm, krrse lartesia e ndenjeses nga dyshemeja jo me pak se 44 cm'
- Dimensionet e ndenjeses jo më pak se 40x40cm
- Skeleti te realizohet nga dru ah masiv, me seksion katror ose i rumbullaket, i Iyer me llak per te ruajtur ngjyren natyrale te drurit.
- Ndenjesja te realizohet me melamine, sfungjer dhe stof.
- Ne cdo rast duhet te sigurojne nje forme te harkuar.
- Ne cdo rast do jete e mbushur me sfungjer dhe e tapicuar me cope stofi ose lekure.
- Mbeshtesja te realizohet me ristela te kurbezuara jo me pak se dy ristela me gjeresi jo me pak se 5 cm ose nje e vetme me gjeresi jo me pak se 10 cm.

18. Tavolina per biblioteke

- Permasat: gjatesia 120 cm, gjeresia 60 cm, lartesia 74 cm, per perdorim nga studentet ne biblioteke. Syprina e tavolines duhet te jete prej material melamine 1.8 cm e borduar me PVC.
- Montimi i kembeve me suprinen realizohet nepernjete nje element lidhes per te siguruar qendrueshmerine e tavolines me permasa 112x35cm, me melamine 18mm e boruati me PVC 0.8mm.
- Kembet e tavolines duhet te jene prej material melamine 1.8 cm me bordura PVC. Kembet te jene te vendosura mbi tapa plastike te cilat lejojne regjistrimin e lartesis se Prodhim, furnizim dhe montim ne shkolle.

19. Rafte biblioteke



- Rafti eshte i dizenuar per biblioteke. Permasat e raftit jane 90 x 40 x 185 cm.
- Faqet vertikale jane me melamine me trashesi, 1.8 cm me veshje perimetrale te plastifikuar me PVC 0.8mm.
- Rafti ka gjithsej 4 (kater) ndarje horizontale te brendshme. Ndareset horizontale te raftit jane melamine 25mm me veshje perimetrale te plastifikuar me PVC 0.8mm.
- Trashesia prej 2.5 cm dhe gjatesia e lire prej 90 cm eshte nje gjatesi optimale, e cila siguron nje hapësire te mjaftueshme, gjithashtu ruan qendrueshmerine dhe nuk deformohet nen veprimin e ngarkeses se librave me kalimin e kohes. Faqja e mbrapme e raftit eshte me perberje fiber me trashesi 3 mm. Montimi do te realizohet me aksesore te fshehur. Prodhim, furnizim dhe montim ne shkolle.

20. Karrige biblioteke



- Lartesia totale 85cm, kurse lartesia e ndenjesis nga dysHEMEJA jo me pak se 44cm.
 - Dimensionet e ndenjesis jo me pak se 40x40cm
 - Skeleti te realizohet nga dru ahu masiv, me seksion katror ose i rumbullaket, i lyster me llak per te ruajtur ngjyren natyrale te drurit.
 - Ndenjesja te realizohet me me lamine, sfungjer dhe stof.
 - Ne cdo rast duhet te sigurojne nje forme te harkuar.
- Ne cdo rast do jete e mbushur me sfungjer dhe e tapicuar me cope stofi ose lekure.
 - Mbeshtesja te realizohet me ristela te kurbezuara jo me pak se dy ristela me gjeresi jo me pak se 5 cm ose nje e vetme me gjeresi jo me pak se 10 cm.

21. Tavolinë drejtuesi në formë L (e madhe)



- Perbehet nga 4 pjesë kryesore
 - Tavoline pune ~(gjatesi~x gjeresi x lartesi) 140 x 70 x 72cm
 - Tavoline kompjuteri (gjatesixgjeresixlartesi) 90x70x72cm
- Hark lidhes 90° me permasa 70 x 70 cm.
 - Tavolina e mbledhjes (gjatesi x gjeresi x lartesi) 130x70x75cm.
 - Syprina melamine me trashesi 2.5 cm.
 - Veshje laminat me rezistence te Jarte kunder gervishtjeve dhe njollave. Kembet jane me material melamine me trashesi 18 mm.
 - Bordet anesore te planit te punes dhe te kembeve te jene te rrethuara me material plastik PVC 0.8mm.
 - Bashkimi i planit te punes me kembet behet ne menyre te tille qe i jep tavolines pamje solide.
 - Pjesa ballore eshte e pozicionuar e tille, qe realizon bashkimin e planit te punes me kembet e tavolines dhe qendron ne nje hapesire 40 cm, nga plani i dyshemese.
 - Aksesoret qe perdoren per montimin e elementeve te tavolines te jene cilesore.
 - Kembet te jene me mekanizem nivelues.

- Tavolina e punes ne.pjesen e brendshme ka te montuar ne njerin krah nje bllok sirtaresh ku sirtari i pare te jete i mbyllur me celes.
- Montimi- dhe- cmontimi te jete sa me i thjeshte.
- Ngjyrat jane te ndryshme dhe percaktimi i sakte i tyre do te behet ne kushtet e lidhjes se kontrates.

22. Tavolinë drejtuesi në formë L (e vogël)



- _Perbehet nga 3 pjesë kryesore
 - Tavoline pune ~(gjatesi~x gjeresi x lartesi) 140 x 70 x 72cm
 - Tavoline kompjuteri (gjatesixgjeresixlartesi) 90x70x72cm
 - Hark lidhes 90° me permasa 70 x 70 cm.
 - Syprina melamine me trashesi 2.5 cm.
- Veshje laminat me rezistence te Jarte kunder gervishtjeve dhe njollave. Kembet jane me material melamine me trashesi 18 mm.
 - Bordet anesore te planit te punes dhe te kembeve te jene te rrethuara me material plastik PVC 0.8mm.
 - Bashkimi i planit te punes me kembet behet ne menyre te tille qe i jep tavolines pamje solide.
 - Pjesa ballore eshte e pozicionuar e tille, qe realizon bashkimin e planit te punes me kembet e tavolines dhe qendron ne nje hapesire 40 cm, nga plani i dyshemese.
 - Aksesoret qe perdoren per montimin e elementeve te tavolines te jene cilesore.
 - Kembet te jene me mekanizem nivelues.
- Tavolina e punes ne.pjesen e brendshme ka te montuar ne njerin krah nje bllok sirtaresh ku sirtari i pare te jete i mbyllur me celes.
 - Montimi- dhe- cmontimi te jete sa me i thjeshte.
 - Ngjyrat jane te ndryshme dhe percaktimi i sakte i tyre do te behet ne kushtet e lidhjes se kontrates.

23. Karrige rrotulluese drejtuesi me rregullim gjatësie



- Shtylla vertikale me sklet të përbërënga pesë këmbë , në formë ylli me pesë rrrpta rrotulluese në formë sferike të përshtatura për dysheme me tapete
 - Zvendosje pa shkallë të pjesës ku rri ulur , me sustë për thellësinë dhe mekanizem clodhës , susta përkuljes e rregullueshme sipas peshës së trupit.
 - Tapiceria e ndjenjësës dhe e mbështetëses e mbushur me material mbushës sfugjer dhe veshur me copë stof , ngjyra sipas dëshirës së porositësit me bordura mbrojtëse.
- Krahët e karriges : Prej plastike , prodhim , furnizim dhe vendosje .

24.Tavolinë zyre

Tavolina përbëhet nga katër elementë me përmasa;

- a) Tavolina e punës 120 x 70 x 72 cm .
 - b) Tavolina e kompjuterit 90 x 70 x72 cm .
 - c) Harku lidhës 70 x 70 x70 cm
 - d) Sirtar komodinë 40 x 42 x 62 cm .
- Tavolina e punës përbëhet nga syprina prej materiali melaminë me trashësi 25 cm me borde anësore të planifikuara me PVC 0.8 MM.Dy anësoret dhe harku lidhës përbëhen nga materiali melaminë me trashësi 1.8 cm .
 - Bashkimi i elementëve të tavolinës së punës bëhet me aksesore të pa dukshëm . Tavolina e punës mbështetet mbi këmbë plastike . Poashtu skeleti i tavolinës së kompjuterit përbhët nga melamina me trashësi 1.8 cm njëlloj si pjesa tjetër dhe poshtë tavolinës vendoset një pjesë për mbajtësen e tastieres së kompjuterit . Komodina mbështet mbi rrota dhe ka tre sirtarë me doreza, të hapshëm me shina ku sirtari i parë detyrimisht duhet të ketë edhe bravë.

25. Raft / Dollap për zyra




- Përmasat : 90 x 45 x 185 cm.
- Skeleti dhe sergjenët do jenë prej materiali melaminë me trashësi 18 mm. Boredet anësore të skeletit , sergjenëve dhe kapakëve të jenë të rrethuar me material plastik PVC0.8mm. Poshtë fiankeve do të ketë këmbëza me mekanizëm nivelues. Në pjesën e poshtme deri në lartësinë 72 cm, do të ketë dy kapakë prej materiali melaminë , me trashësi 1.8 cm që mbyllën me çelës.
- Dollapi brenda këtyre dy kapakëve do të jetë I ndarë në dy pjesë me anë të një sergjieni me lartësi të rregjistrueshme. Pjesa e sipërme është mbyllur me kapakë xhami me/ose pa kornizë . Hapësira brenda kapakëve të xhamit do të ndahet në tre hapësira me anë të dy sergjenëve. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës Prodhim, Furnizim dhe montim në shkollë.

26. Karrige zyre e thjeshtë (510 x 450 x 780 mm)



- Shpina dhe ulësja të jenë të bëra me plastikë të zezë, rezistente ndaj goditjeve, të mbushura me gomë akrilike me trashësi 35 mm dhe dendësi 28 kg / m³ , i ngjitur me lëndë ngjitëse , për të krijuar formën ergonomike dhe të veshur me tekstil (tapiceri) .
- Pjesa e poshtme e ulëses dhe e pasme e shpinores mbulohe me kapak plastik të së njëjtës forme.
- Përmasat e ulëses të jenë : 450 x 400mm , ndërsa të shpinores të jenë 350 x 450 mm.
- Lartësia e ulëses dhe shpinores të jenë përkthsisht 400-460mm dhe 700-750 mm.
- Strukura e mbajtëses të jetë e përbërë prej profil çeliku oval me përmasa 30 x 15 mm, me spesor 1.2 – 1.5 mm, I harkuar me kalnder.
- Kjo strukturë të jetë e salduar me argon ose me shkarkesë elektrike dhe e lyer me furrë elektrostatische.

27. Tavolinë mbledhje salle mësuesi (e madhe) (224 x 120 x 75 cm)



- Permasat (gjerësi x thellesi x lartësi): 240 x 120 x 75 cm
- Syprina melamine me trashësi 2.5 cm.
- Veshje laminati me rezistence të lartë kundër gervishtjeve dhe njollave.
- Kembet janë me plane të të njëjtit material dhe trashësi të syprines.
- Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC 0.8 mm.
- Bashkimi i planit të punës (syprines) me kembet bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolines pamje solide.
- Aksesoret që përdoren për montimin e elementeve të tavolines të jenë cilësore.
- Kembet të jenë me mekanizëm nivelues.
- Syprina e tavolines përbehet nga 4 elemente o Dy elemente me pennasa 130 x 55 cm që vendosen paralalisht me njëri tjetrin duke lënë një hapësirë 10 cm midis tyre. o Dy

elementet e tjere jane ne permasa 120 x 55 cm, dhe jane ne forme gjysmerrethi. Duke u vendosur perballe njera tjetres, ne dy anet e ngushta te dy elementeve te pare ijapin tavolines nje pamje ovale

28. Tavolinë mbledhje salle mësuesi (e vogel) (220 x 80 x 72 cm)



- Permasat (gjatesi x gjeresi x lartesi):220 x 80 x 75
 - Syprina melamine me trashesi 2.5 cm.
 - Veshje laminati rr.:e rezistence te larte kunder gervishtjeve dhe njollave.
 - Kembet jane me plane te te njejt material dhe trashesi te syprines. Bordet anesore te planit te punes dhe te kembeve te jene te rrethuara me material plastik PVC 0.8 mm.
- Bashkimi i planit te punes me kembet behet ne menyre te tille qe i jep tavolines pamje solide.
 - Aksesoret qe perdoren per montimin e elementeve te tavolines te jene cilesore.
 - Kembet te jene me mekanizem nivelues. Montimi dhe 9montimi te jete same i thjeshte.
 - Ngjyrat jane te ndryshme dhe percaktimi i sakte i tyre do te behet ne kushtet e lidhjes se kontrates.

29. Karrige per sallën e mesuesve



- Lartësia totale 85 cm , kurse lartësia e ndjenjësës nga dyshemeja jo më pak se 44 cm.
- Dimensionet e ndjenjësës jo më pak se 40 x40 cm .
- Skeleti të realizohet nga dru ah masiv, me seksion katror ose i rrumbullakët , i lyer me llak për të ruajtur ngjyrën natyrale të drurit.
- Ndenjësja te realizohet me melaminë , sfungjer dhe stof.
- Në çdo rast duhet të sigurojnë një formë të harkuar.
- Në çdo rast do të jetë e mbushur me sfungjer dhe e tapicuar me copë stofi ose lëkure.
- Mbështesja të realizohet me ristela të kurbëzuara jo më pak se dy ristela me gjerësi jo më pak se 5 cm ose një e vetme me gjerësi jo më pak se 10 cm.

30. Portomanto për dhomën e mësuesve

- Materiali melaminë me trashësi 1.8 cm me përmasa të varësës së montuar 90 x 70 cm . Në pjesën e sipërme vendosen në distancë të barabartë 6 gremca për varjen e rrobave .
prodhim , furnizim dhe montim në shkollë.

31. Raftë për çdo mësues në sallën e mësuesve



- Përmasat : 90 x 45 x 185 cm
- Raftet do të realizohen me 15 hapësira që qëndrojnë mbi njëra tjetrën. Me lartësi të njëjtë. Hapsirat shërbejnë si sipërfaqe mbajtëse të paisjeve të klasës.
- Pjesa e pasme e dollapit është e përbërë me fibër , në faqen e dukshme më të njëjtën ngjyrë dhe dizenjo me pjesën tjetër të dollapit. Për çdo hapsirë të ketë kanata me hapje 90 °, doreza e bravës me çelës.
- I gjithë rafti mbështet mbi këmbëza plastike 6 cm . Materiali I gjithë dollapit do të jetë melaminë me trashësi 1.8 cm. Trupi, ndarëset për të gjitha pjesët e dukshme vishen material plastikë PVC (në pjesën anësore).

- Ndarjet horizontale të raftit prej pllake zdrukthi e melaminuar me trashësi 1.8 cm.
- Lidhja do të realizohet me aksesore të fshehur . Prodhim, furnizimin dhe montim në shkollë.

32. Dollap Garderobe për stafin

- Përmasat do të jenë më të vogla se:
Lartësia 185 cm
Gjerësia 90 cm
Thellësia 45 cm
- Mbështetur mbi këmbë plastike me gjatësi 6 cm
- Lidhja me montimi të jetë me bulon të fshehur
- Me një kapak të paisur me bravë.
- Prodhim me material melaminë spesor 1.8 cm .
- Të gjithë dollapet do të pajisen me brava dhe metesha për hapje.
- Prodhim, furnizim dhe montim shkollë.

33. Tavolinë për sallë polifunkionale

- Përmasat : 250 x 80 x 72 cm. Syprina e tavolinës duhet të jetë prej materiali melaminë me trashësi 1.8 cm . Këmbët janë me të njëjtin material dhe trashësi me atë të syprinës.
- Një element lidhës me lartësi 40 cm nga toka , me melaminë 18 mm.
- Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që të sigurojë një lidhje solide.
- Aksesoret që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës duhet të jenë të fshur dhe të jenë cilësore . Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Tavolina duhet të ketë një hapësirë pune të mjaftueshme për deri 4 persona . Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës Prodhim, Furnizim dhe montim

34. Karrige për sallë polifunkionale



- Lartësia totale 85 cm, lurse lartësia e ndjenjës nga dyshemeja jo më pak se 44 cm
- Dimënsionet e ndjenjës jo më pak se 40 x 40 cm.
- Skeleti të realizohet nga dru ah masiv , me seksionet katror ose i rumbullakët , i lyer me llak për të ruajtur ngjyrën natyrale të drurit.
- Ndenjësja të realizohet me melaminë , sfungjer dhe stof.
- Në çdo rast duhet të sigurojnë një formë të harkuar.
- Në çdo rast do të jetë e mbushur me sfungjer dhe e tapiciruar me copë stofi ose lëkurë.
- Mbështetësja të realizohet me ristela të kurbëzuara jo më pak se dy ristela me gjerësi jo më pak se 5 cm ose një e vetme më gjerësi jo më pak 10 cm.

35. Dollap për arkivin (90 x 40 x 195 cm)



- Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi) : 90 x 40 x 195 cm
- Dollap metalik me dyer duhet të ketë strukturë prej çeliku të lyer që të rezistojë korozionit dhe përkuljes.
- Dollpai duhet të sigurojë mbyllje me çelës .
- Hapësira e brendshme e dollapit ndahet në 5 hapsira.
- Sergjenët ndarës duhet të kenë përshtatje lartësiejo më shumë se 30 mm dhe të kenë aftësi mbajtëse jo më pak se 50 kg.
- Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë.

- Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

36. Raft per infermierine

- Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 90x45x185 cm.
- Materiali i përdorur është melamine me trashësi 1.8 cm. Elementët vertikale dhe horizontale janë me po të njëjtin material dhe trashësi të strukturës.
- Etazheri në pjesën e poshtme do të përbëhet nga dy kapakë dhe pjesa e brendshme do të jetë e ndarë në dy hapësira të barabarta. Kapakët do të trajtohen me bordime të plastifikuara.
- Pjesa e sipërme e etazherit do të jetë e hapur dhe e ndarë në tre hapsira të barabarta nëpërmjet 2 sergjeneve. Etazheri do të qëndrojë mbi këmbë plastike me lartësi 6 cm. Montimi do të realizohet me aksesore të padukshme.
- Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

37. Shtrat vizite për infermierinë

- Shtrati i vizitës do të ketë dimensione të përafërta 180cm x 60 cm. Lartësia 80cm. Sipërfaqia të jetë e përbërë nga një segment fiks dhe një segment me kënd rregullueshëm. Peshë mbajtëse jo më pak se 100Kg.
- Skeleti do të ndërtohet me profil metalik tubular me seksion katror 40x40mm spesor jo më të vogël se 1.2 - 1.5mm. Elementët lidhës do të jenë profil tubular seksion 40x20mm me spesor jo më të vogël se 1.5mm
- Si mbëshjetje do të kemi pllakë zdrukthi të veshur me sfungjer të cilësisë së lartë e veshur me tekstil.

Specifikimet teknike janë të mbështetura në shkresën e ardhur nga Ministria e Arsimit Rinisë dhe Sportit nr. 1668/4 prot., datë 07.03.2024 e protokolluar me tonën nr.2128 prot., datë 12.03.2024.

Grupi i Punës

- **Florilda Dema**
- **Arjana Cani**
- **Artur Çajka**

